



Duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 33 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Klinës, bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, të marrin pjesë në mbledhjen e IV-të të KPF-së e cila mbahet me datë: 07.04.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në ora 09:00.

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2025 (ref.dejt.Fin.),
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025 (ref.nga EKZ),
5. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të kryetarit të komunës për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.06-8532/2025 dhe 01Nr.06-8705/2025 (ref. nga EKZ),
6. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.553-8606/2025 dhe 01Nr.553-8607/2025 (ref.nga DKA),
7. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimit 01Nr.644-8473/25 (ref.nga DKRS),
8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt mars-prill 2025,
9. Të ndryshme.

01Nr. 06-8754 2025
Klinë, më 28.03 2025



Kryesuesi,
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Pozivajući se na član 52. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, član 33 Statuta opštine Klina, članovi 15 i 16 i 17 Poslovnika o radu Skupštine i opštinskih odbora, predsednik komiteta za politiku i finansije opštine Klina, vrsi sledece:

OBAVESTENJE

Pozivaju se svi članovi Odbora za politiku i finansije da učestvuju na 4. sastanku KPF-a koji se održava: 07.04.2025 godine u sali Skupštine opštine Klina, sa početkom u 09:00 časova..

DNEVNI RED

1. Opravdanje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje izveštaja o finansijskom upravljanju za januar-mart 2025. (ref. dir. Fin.),
4. Razmatranje predloga odluke o prenosu preostalih sredstava iz sopstvenih prihoda za 2024. godinu u 2025. godinu (ref. EKZ),
5. Razmatranje predloga odluka predsednika opštine o dodeli finansijskih sredstava prema predlozima 01Nr.06-8532/2025 i 01Nr.06-8705/ 2025(ref. EKZ),
6. Razmatranje predloga odluka DKA o dodeli finansijskih sredstava prema predlozima 01Nr.553-8606/2025 i 01Nr.553-8607/2025 (ref. DKA),
7. Razmatranje zahteva DKRS za dodelu finansijskih sredstava prema predlogu 01Nr.644-8473/25 (ref. DKRS),
8. Razmatranje pristiglih zahteva za Komitet za politiku i finansije za mart-april 2025.,
9. Razno.

01Br. 060-8754 2025
Klina, 28.03 2025



Predsedavajuci
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

Një
U.
Organi

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Int
ost

26.03.2025

01-644-8473/25

Për:	Kuvendin Komunal, Kryesuesin e kuvendit z.Fadil Gashi Komitetit për politikë dhe financa
Nga:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Klinë, Drejtor: Driton Bardheci
Lënda:	Kërkesë
Datë:	26.03.2025
Vendi:	Klinë

I nderuar kryesues z. Fadil Gashi

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kërkon nga ju që në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal në muajin prill, të vendoset pikë diskutimi dhe në votim ndarja e mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve në DKRS, për festivalin "I Këndojmë Lirisë" edicioni i 23-të, në vlerë prej 30.000 € (tridhjetë mijë euro).

Me respekt!





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org



Për/To/Za :	Komitetin për Politikë dhe Financa
Nga/From/Od :	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - z. Enver Berisha
Përmes/Through/Preko :	z. Zenun Elezaj – Kryetar i KK- Klinë
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025
Data :	28.03.2025

Të nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 , kërkojmë bartjen e mjeteve të pashpenzuara dhe mjetet nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartjen në vitin 2025, gjithsej shumën prej **624,854.99 €**.

Nga shuma e përgjithshme **624,854.99 €**, nga fondi 21 dhe 22 është shuma prej 293,727.28 € dhe nga tejkalimi i planifikimit të të hyrave shuma prej **331,127.71 €**. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave Ligjit të buxhetit për vitin 2025 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

- Mallra dhe Shërbime në shumën prej **90,000.00 €**;
- Shpenzimet komunale në shumën prej **90,000.00 €**;
- Subvencione dhe transfere shumën prej **92,746.95 €**.
- Shpenzime kapitale në shumën prej **352,108.04 €**;

Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Arsimi Parafillor (92550), shuma prej **7,619.50 €**;

Arsimi Mesëm (94710), shuma prej **11,936.30 €**;

Administrata (16318), shuma prej **5,000.00 €**;

Shërbimet kulturore (85018), shuma prej **8,000.00 €**;

Buxhetimi (17518), shuma prej **57,444.2 €**;

Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej **50,000.00 €**;

Administrata e arsimit (92090) shuma prej **40,000.00 €**.

Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve

Zyra e Kryetarit (16018) shuma prej **20,000.00**;

Administrata e arsimit (92090) shuma prej **2,800.00 €**;

Shërbimet kulturore (85018), shuma prej **69,946.95 €**.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Ndertimi i infrastruktures nentoksore dhe mbitoksore ne Siqueve-Ujmire-Shtarice”, kodi (54924), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentoksore dhe mbitoksore ne Poterq-Dugajeve-Drenoc”, kodi (54344), shuma prej 25,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj”, kodi (56059) shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj”, kodi (56063), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitoksore(Trotuare) dhe infrastruktutes nentokesore ne Zajm-Deiq”, kodi (56074), shuma prej 15,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe infrastruktures nentokesore Volljake-Sferke-Qupeve-Dush”, kodi (56084), shuma prej 15,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe infrastruktutes nentokesore Gjurgjevik i madh-Dush”, kodi (56094), shuma prej 25,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe nentokesore ne Jashanice-Jelloc-Resnik”, kodi (56106), shuma prej 21,000.00 €.

Bujqësi (47018), në projektet:

“Ndërtimi i kanaleve te ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj”, kodi (56152), shuma prej 44,698.91 €.

Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Rindertimi i infrastruktures mbitokesore me asfalt ne Jashanice,Shtupel,Zllakuqan,Kline-Videje etj”, kodi (56126), shuma prej 50,000.00 €;

Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), në projektet:

“Ndertimi dhe rindertimi I objekteve shendetesore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj”, kodi (56149), shuma prej 150.00 €.

Shërbimet Rezidenciale (75587), në projektet:

“Ndertimi i shtepise se pleqeve ne Kline”, kodi (54463), shuma prej 15,000.00 €.

Administrata (16318), në projektet:

“Blerja e veturave zyrtare per nevoja te Administrates Komunale”, kodi (54370), shuma prej 22,290.00 €

Shërbimet Kulturore (85018), në projektet:

“Ndertimi dhe Rindertimi i Objektit Sportiv dhe te Kultures ne Kline”, kodi (56154), shuma prej 38,969.13 €

Arsim dhe Shkencë - Administrata (92090), në projektet:

“Ndertimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pellet ne shkolla në Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik I Madh, Budisalc, Ujmirë, Dren (56137), shuma prej 10,000.00 €;

“Ndërtimi I fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siquevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj”, kodi (56147), shuma prej 10,000.00 €.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

01-Nr. 451-8739 2025

Klinë më dt: 28.03 2025

PËR: Komitetin për Politikë dhe Financa.

PËRMES: Kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj,

NGA: Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z. Enver Berisha.

LËNDA: Kërkesë për hyrjen në rendin e ditës shqyrtimi i Raportit Financiar janar-mars 2025

Kërkojmë që të na mundësohet hyrja në rendin e ditës shqyrtimi i Raportit Financiar janar-mars 2025.

Duke u bazuar se ne SIMFK ende nuk është mbyll periudha e muajit mars 2025 materialin (Raportin Financiar janar-mars 2025) ju dërgojmë para datës së mbledhjes së KPF-së

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr _____/25

Klinë, dt: _____/25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 07.03.2025, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi zv. Kryesuesi, Tunë Deda, i cili përshëndeti drejtorët e drejtorive, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit. Përveç pikave të parapara në rendin e ditës, Komiteti shqyrtoi edhe propozim-vendimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të monitorimit të HZK-së 2020-2028.

Zv. Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

- 1. Arsyeimi i mungesave;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për Rregulloren për Transparencë të Komunës së Klinës dhe Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029 (ref. nga grupi punues);**
- 4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë 2025-2029 (ref. nga grupi punues);**
- 5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Transparencë të Komunës së Klinës (ref. nga grupi punues);**
- 6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt shkurt-mars 2025;**
- 7. Të ndryshme.**

Tunë Deda: Po hap debat rreth rendit të ditës. A ka dikush vërejtje për rendin e ditës?

Me 6 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsytimi i mungesave.

Tunë Deda: Jemi të gjithë të pranishëm, përveç kryesuesit, i cili pritet t'i bashkëngjitet mbledhjes.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Tunë Deda: Kush është për procesverbalin e seancës së kaluar?

Me 6 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për rregulloren për transparencë të Komunës së Klinës dhe plani i veprimit për transparencë komunale 2025-2029 (ref. nga grupi punues).

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Mirëmëngjesi të gjithëve! Nuk isha ndal shumë gjatë, për shkak që materiali ju është dorëzuar me kohë dhe raporti nga procesi i ka vetëm disa pika pak më të rëndësishme, e që është bazuar në Udhëzimin Administrativ për Komunitet e hapura. Kryetari i komunës me kohë ka nxjerrë vendimin për grupin punues që i harton këto dokumente edhe që është marr me pjesën e konsultimit publik. Ky dokument ka qenë pjesë e planifikimit të konsultimeve për vitin 2024 dhe u publikua me kohë në faqen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë rast, i kemi mbajtur dy takime:

Takimi i parë, ka qenë i drejtpërdrejtë në sallën e kuvendit, ku kanë marr pjesë 15 persona; 2 pjesëmarrës kanë parashtruar komente.

Takimi i dytë ka qenë në shkollën e mesme profesionale “Fehmi Agani” Klinë, ku kanë marr pjesë 11 pjesëmarrës dhe 0 komente të regjistruara.

Ajo që ka qenë më e rëndësishme, komentet që i kemi marr online, duke pasur parasysh që udhëzimi ta jep një mundësi me i dorëzuar komentet edhe gjatë takimeve të drejtpërdrejta edhe

me imell, kështu që, i kemi marr disa komente interesante. Një ka qenë nga Vitore Zefi, që ka thënë se, raportet të cilat i dorëzojnë OJQ-të kur t'i marrin subvencionet me qenë të gjithsecilës të publikuara në ueb-faqe. Ndërsa organizata "D PLUS" ka dhënë propozimet e saj. Raporti është punuar në dhjetor, nëse nuk gaboje në fillim të janarit të vitit 2025, po e kam cekë edhe në seancë, që për shkak të angazhimit, zyra për Informim nuk ka pasur mundësi me i sjell më herët për miratim. Kështu që, janë pjesë e seancës së ardhshme, që do të mbahet me 21 mars nëse s'gaboje.

Edhe nga të gjithë kontribuuesit, grupi punues ka regjistruar 15 kërkesa, prej të cilave: 13 janë vonuar; 1 është refuzuar dhe; 1 është pjesërisht e pranuar. Përkthyer në përqindje, janë këto shifra: 6.6% janë pjesërisht të pranuar; 6.6% janë të refuzuara dhe; 6.6% janë të pranuar.

Gjatë këtyre takimeve: 12 prej pjesëmarrësve kanë qenë femra dhe 14 meshkuj, që i bie në total 26 pjesëmarrës. Procesverbalet kanë qenë publike në ueb-faqe, bashkë me këtë raport nga procesi i organizimit të konsultimit publik.

Tunë Deda: Faleminderit, Vlora. Nëse s'ka dikush, kalojmë te pika e katërt.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për rregulloren për transparencë të Komunës së Klinës dhe planin e veprimit për transparencë komunale 2025-2029, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i planit të veprimit për transparencë 2025-2029 (ref. nga grupi punues).

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Plani i veprimit i paraprin rregullores, që çfarëdo që ka në rregullore, veç është e thjeshtësuar pjesë- pjesë edhe më në detaje në planin e veprimit. Nëse nuk gaboje, planit të veprimit për transparencë i ka dal afati në dhjetor 2024, ndaj jemi obliguar t'i krijojmë planet e reja të veprimit.

Plani i veprimit për transparencë komunale e përfshinë padyshim: Kuvendin si organin më të lartë ligjvënës, Kryetarin, drejtoritë dhe dikasteret tjera që janë me rëndësi.

Ajo çka përfshin plani i veprimit janë këto detaje të veprimit që zakonisht i merr zyra për Informim: Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të hapësirave për pjesëmarrje me publikun, kontakti me përfaqësues të mediave, numri i njoftimeve të shpallura në dy gjuhë zyrtare. Është gjithçka që lidhet me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe propozimin administrativ që teknikisht ju si anëtarë të kuvendit edhe jeni të përfshirë. Pastaj është publikimi i dokumenteve strategjike dhe politikave të kuvendit të komunës, publikimi i planeve hapësinore, plani zhvillimor të komunës i hartave zonale, që janë në kuadër po ashtu të kuvendit, publikimi i raporteve të komunës së kuvendit, publikimi i dokumenteve të prodhuara nga kuvendi, përfshirë procesverbalet e takimeve, komiteteve edhe vendimet e kuvendit, publikimi i video incizimit dhe mbledhjeve të kuvendit të komunës, materialeve të tjera të tel prezencës dhe ligjet përcjellëse. Do të thotë, gjithçka që ka të bëjë me aktivitetet e kuvendit, sa i përket transparencës, duhet të

jetë e qasshme për publikun.

Pra, të gjitha departamentet, përfshirë kryetarin dhe drejtoritë, ndahen bazuar në udhëzimin administrativ dhe obligimet që dalin. Të gjitha duhet të jenë të qasshme për publikun, veçanërisht ato që janë konfidenciale dhe parashihen të jenë pjesë e ueb-faqes. Te pjesa e planit të veprimit është më shumë teori, e ndërsa shtojca e planit të veprimit për transparencë është më teknike, edhe veç e kam quajtur si shtojcë, po është një dokument.

Tunë Deda: Faleminderit, Vlora. Kalojmë te pika e pestë e rendit të ditës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-rregullores për transparencën e Komunës së Klinës, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që e njëjta të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për transparencë e Komunës së Klinës (ref. nga grupi punues).

Tunë Deda: Prapë referon Vlora Tafili.

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Po, kryesues, planit të veprimit të cilin e prezantova më herët i paraprin draft-rregullorja për transparencë. Draft-rregulloren për transparencë jemi obliguar që ta hartojmë bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si dhe Udhëzimin për Administratën e komunës, Statusin e komunës edhe kuvendi e nxjerr këtë Rregullore për transparencë. Kjo rregullore përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, drejtorive, kuvendit si dhe mekanizma të tjerë ligjorë, si dhe rregullave të parimit dhe formave të përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin e vendimmarrjes edhe në kapituj të ndryshëm të ndarë. E kemi transparencën, siç e përmenda më herët, të kuvendeve, të drejtorive, të kryetarit, të organeve tjera të rëndësishme. Sa i përket mbledhjeve të kuvendit, komuna e Klinës i ka tri transmetime: një me tel prezencë te MAPL-ja; një te radio “Alba” dhe; një te Klina.info. Kështu që, në këtë pikë qëndrojmë mjaft mirë si komunë. I kemi materialet e kuvendit, vendimet janë të gjitha me numër, faleminderit Ahmetit, edhe këto si kuvend kanë qenë mjaftë transparente. Të gjitha vendimet që i ka bërë kuvendi, edhe ato që kanë shkuar për shqyrtim, dhe ato të shfuqizuara janë pjesë e ueb-faqes, dhe monitorohen elektronikisht gjatë mbledhjeve. Të gjitha këto ju i keni, veç keni kaluar nëpër to, po që duhet patjetër me qenë të rregulluara me një dokument.

E kemi kapitullin e tretë, transparenca e ekzekutivit: Kryetari i komunës ofron transparencë për vendimmarrjen e tij dhe drejtorive tjera. Kryetari i komunës raporton para kuvendit, ai merr vendim të veçantë, ka të drejtë të përcaktojë rregullat e hapjes së menaxhimit të rrjeteve sociale dhe ato të transmetimit. Dmth, përveç ueb-faqes, komuna e Klinës i ka edhe dy rrjete sociale, e kemi edhe publikimin e dokumenteve zyrtare financiare.

Në rregullore dhe në plan të veprimit kemi shkuar shumë shkurt, që mos ta bëjmë dokumentin

më monoton. Përveç këtyre dokumenteve që ju i shihni në nene dhe në kapituj, që obligohemi t'i publikojmë, ka edhe shumë dokumente tjera që zyrtarja kryesore financiare që është pjesë e Drejtorisë së Financave, është mjaftë aktive dhe gjitha dokumentet financiare të rëndësishme me të cilat vlerësohemi dhe monitorohemi i ka në ueb-faqe, përfshirë buxhetin vjetor, e që është e rëndësishme që komuna i ka tri lloje të dokumenteve që i publikon. Duke pasur parasysh edhe rëndësinë e verifikimit të dhënave, p.sh. buxhetin vjetor të komunës e ka në tri formate edhe e ka përcjell në tri gjuhë, dmth word, excel, pdf dhe këtë që miratohet në kuvend. Është transmetuar transparenca tek aktiviteti i prokurimit, po ashtu 100% si komunë jemi te publikimi sa i përket raportit të performancës dhe vlerësimit të publikimit të dokumenteve zyrtare, të cilat dalin nga zyra e prokurimit.

Ju si anëtarë të KPF-së, pasi ende nuk është përcjell në kuvend dhe miratim, në qoftë se keni një kërkesë sa i përket gjitha këtyre dikastereve që i përmenda, diçka që ju intereson ai dokument, që mendoni që nuk është pjesë e ueb-faqes dhe do t'i kontribuonte shumë transparencës. Unë jam e hapur, se për momentin jemi duke e hartuar draftin, dhe komentet nga Komiteti për Politikë dhe Financa do t'i përcjellim pastaj në kuvend.

Tunë Deda: Faleminderit, Vlora. Nëse ka dikush diçka rreth rregullores, kush e dëshiron fjalën? Atëherë, kush është për shqyrtim dhe miratim në Kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të planit të veprimit për transparencë 2025-2029, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt shkurt-mars 2025.

Tunë Deda: Nuk kemi asnjë kërkesë.

Pika 7. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të monitorimit të HZK-së 2020-2028.

Tunë Deda: Fjalën e ka drejtori i Urbanizmit, z. Enver Berisha.

Enver Berisha, drejtor i DUMM: Faleminderit, Kryesues. Përhëndetje për ju, anëtarë të KPF-së. Drejtorja e Urbanizmit ka bërë një raport, i cili është me baza ligjore dhe është i obligueshëm në raport që i paraprinë inicimit të procedurave për revidim të hartave zonale. Në qoftë se raporti merret parasysh, atëherë në qoftë se nuk e ka zbatueshmërinë e nevojshme, atëherë duhet të sjellin prapë kërkesën para jush për revidim të hartës zonale.

Ky raport i monitorimit është gjendje aktuale e këtij dokumenti se sa është i zbatueshëm ky në

teren. Ne e kemi paraparë se shkalla e zbatueshmërisë është shumë më e vogël me atë çka është menduar në fillim. Dmth harta zonale është dokument i cili kryesisht shërben për kriteret e ndërtimeve dhe zhvillimeve të komunës, e në këtë rast, meqenëse harta është miratuar në vitin 2020 për periudhën deri në 2028, me formë ligjore sipas Udhëzimit Administrativ 24\2015 e ka të obligueshëm revidimin e hartës së saj në qoftë se ka nevojë, por pas 4 viteve dhe njëkohësisht që 4 vite, ne kemi parë se kjo hartë ka pasur shumë ngecje dhe mos zhvillim. Atëherë e kemi monitoruar dhe e kemi bërë një raport ku ka ngecje, me tregues një nga një.

Kështu që, ky raport është vetëm me u parë se sa ka ngecje, ndërsa, në qoftë se ky miratohet prej asamblesë dhe do të kërkohet ligjshmëria e tij, atëherë vazhdojmë me procedura tjera të ndryshimit të hartave zonale të revidimit të saj, sepse para mbledhjes së ardhshme do t'ju sjellim materialin të gjithëve dhe me parë materialin ku ka ngecje dhe pse duhet ndryshuar.

Faleminderit.

Tunë Deda: Faleminderit, drejtor. Nëse ka dikush rreth raportit? Atëherë, nëse s'ka, kush është për shqyrtim dhe miratim të këtij raporti në Kuvend?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit për monitorimin e Hartës Zonale 2020-2028, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

8. Të ndryshme.

Tunë Deda: Atëherë, nëse s'ka ndonjë çështje tjetër për diskutim, po e përfundojmë mbledhjen. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen!

**Procesmbajtësja,
Monika Palushi**

**Zv. KRYESUESI,
Tunë Deda**



PËR: Komitetin për Politike dhe Financa, kryesuesin, **z. Fadil Gashi**;
Shërbimin për punë të Kuvendit, udhëheqësin, **z. Ahmet Berisha**;

NGA: Kryetari i Komunës së Klinës, **z. Zenun Elezaj**;

LIDHJA: Kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Klinë, nr.01-345-7832/2025 e datës 19.03.2025;

LËNDA: Kërkesë për financim të një veture për Bashkësinë Islame në Klinë;



I nderuar kryesues,
Të nderuar anëtarë të KPF-së,

Më datën 19.03.2025 kam pranuar një kërkesë nga ana e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës Dega në Klinë, për financimin e blerjes së një veture për nevojat e BIK në Klinë, për lehtësimin e shërbimeve për qytetaret e Komunës së Klinës.

Andaj mbi bazën e kërkesës se lartpërmendur me ane të kësaj shkrese kërkojmë nga Komiteti për Politikë dhe Financa që të shqyrtoj mundësitë financiare për financimin e një veture, si dhe t'i rekomandoj Kuvendit të Komunës marrjen e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për blerjen e një veture për nevojat e BIK-ut në Klinë.

SHTOJCË: Bashkëngjitur gjeni kërkesën e BIK-ut, nr.01-345-7832/2025 të datës 19.03.2025.

Me respekt,

01Nr. 06-8532 /2025
Klinë, datë 27/03/2025

REPUBLIKA E KOSOVES

19.03.2025

Nje
U
Organ...

01. 345-783275



KËSHILLI I BASHKESISË ISLAME

Nr:07/25

Më:17.03.2025

KLINË

Për: Zyren e Kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj

Nga: Këshilli i Bashkësisë Islame Klinë

Lënda: Kërkesë për blerjen e një Veture për transport Kufoma.

Këshilli i Bashkësisë Islame në Klinë i drejtohet më kërkesë zyrës së Kryetarit të Komunes së Klinae z. Zenun Elezaj për blerjen e një veture që do te siguronte transportin e Kufomave dhe do të lehtësonte shërbimet fetare per Qytetarët e Komunës sonë.

Qmimi i blerjes së veturës arrin vleren 15.000 €.

Shpresojmë së kërkesa jonë do të hasë në mirekuptimin tuaj, Ju faleminderit.



KRYETARI

z.Kadri Berisha



PËR: Komitetin për Politike dhe Financa, kryesuesin, **z. Fadil Gashi**;
Shërbimin për punë të Kuvendit, udhëheqësin, **z. Ahmet Berisha**;

NGA: Kryetari i Komunës së Klinës, **z. Zenun Elezaj**;

LËNDA: Kërkesë për mbështetje të Stacionit Policor në Klinë;



I nderuar kryesues,
Të nderuar anëtarë të KPF-së,

Duke marre parasysh bashkëpunimin e mire të Komunës së Klinës dhe Stacionit Policor në Klinë, shprehim gatishmërinë e mbështetjes në përmirësimin e kushteve sipas nevojave të Stacionit Policor në Klinë.

Me ane të kësaj shkrese i drejtohem Komitetit për Politike dhe Financa më kërkesën që të shqyrtoj mundësitë financiare dhe t'i propozoj Kuvendit të Komunës së Klinës ndarjen e shumës prej 11,000.00 € (Njëmbëdhjetë mijë euro), më qellim të plotësimit të nevojave dhe krijimit të kushteve më të mira të Policisë së Kosovës përkatësisht Stacionit Policor në Klinë.

Me respekt,

01Nr. 06-8405 /2025
Klinë, datë 28/03 /2025